



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio MIX
Ljubisa Jovic
Drejtor
Priluzje

Ankesa Nr. 2014/270 KPM vs Radio Mix
Ref:1502/175/ KPM/a.z

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2014/270– Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Radio Mix (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 gusht 2009, ka vendosur që subjektit transmetues Radio Mix-Palë Përgjegjëse t'i lëshoj licencë për transmetim si radio lokale në Priluzje.
2. KPM, me datën 31 dhjetor 2011, ka pranuar një njoftim përmes emailit nga Palë Përgjegjëse, ku theksohet se Pala Përgjegjëse për shkaqe financiare do të ndërpresë transmetimin e programit. Përmes këtij emaili Pala Përgjegjëse e ka njoftuar KPM, se e ka ndërprerë transmetimin e programit, duke mos e specifikuar edhe heqjen dorë nga licenca.
3. Me qëllim të verifikimit të njoftimit të pranuar përmes emailit lidhur me atë se nëse Pala Përgjegjëse kishte për qëllim vetëm njoftimin për ndërprerje të përkohshme të transmetimit apo heqjen dorë përfundimisht nga licenca e KPM-së, KPM me datën 21 janar 2012, i ka dërguar shkresë Palës Përgjegjëse përmes së cilës është njoftuar se rasti i Palës Përgjegjëse do të procedohet në Komision për shqyrtim dhe se Pala Përgjegjëse do të njoftohet zyrtarisht për vendimin e KPM-së. Pala Përgjegjëse asnjëherë nuk e ka konfirmuar pranimin e shkresës në mënyrë që KPM të zhvilloj procedurën e shpalljes së pavlefshme të licencës.
4. KPM, me datën 23 prill 2013, ka realizuar një vizitë në terren me qëllim të verifikimit të vazhdimit të punës së Palës Përgjegjëse, pasi që njoftimi për mos transmetim nuk është bërë nga ana e pronarit të Radio Mix por nga ana e njërit nga punëtorët radios. Gjatë vizitës zyrtarët e KPM-së nuk kanë arritur ta takojnë pronarin e Radio Mix, ndërsa kanë vërejtur se ende është e vendosur antena e transmetuesit të Palës Përgjegjëse, ndërsa në frekuencën 97.2 MHz, frekuencë kjo e Palës Përgjegjëse transmetohej program i një radio të huaj jashtë Kosovës.

5. Me datë 24 prill 2013, zyrtarja për monitorim regional për regjionin e Mitrovicës ka kontaktuar me z. Dragisha Lazic-përgjegjës për Radio Mix, përgjegjës pas pronorit të Radio Mix, i cili është shprehur se nuk dëshirojnë të heqin dorë nga licenca e KPM-së, dhe se për arsye financiare nuk kanë mundur të transmetojnë më herët.
6. Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 15 gusht 2014, Departamenti i Menaxhimit Frekunecor i KPM-së ka bërë vizitë te Pala Përgjegjëse ku përmes matjeve ka konstatuar se Pala Përgjegjëse nuk është duke transmetuar në frekuencën 97.2 MHz, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 12 “Ndërprerja e Transmetimit” të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
7. KPM sërish me datën 16 janar 2015, ka bërë vizitë në terren në Priljuzhe dhe ka konstatuar se Pala Përgjegjëse vazhdon me mos transmetim të programit në frekuencën 97.2 MHz duke vazhduar të veprojë në shkëlqje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
8. Pala Përgjegjëse, në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar edhe në kundërshtim me Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës për Licencë KKPM-2010/02, neni 5, paragrafi 1, pasi që ka dështuar të paguajë taksën për licencë për vitin 2012, 2013 dhe 2014. Pala Përgjegjëse si rezultat i mos pagesës së takueses në mënyrë të vazhdueshme, është proceduar në Gjykatën Themelore për procedim të mëtutjeshëm.

Analiza Ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediav bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 “Ndërprerja e Transmetimit” të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës për Licencë KKPM-2010/02.

Neni 12 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton se:

“Ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit nga i Licencuari, do të shërbejnë si bazë që KPM-ja të rishikojë rrethanat që mund të qojnë deri në anulimin e Licencës.”

Pala Përgjegjëse gjithashtu ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2010/02, i cili përcakton se:

“Taksa Vjetore për licencë për shërbime mediale audio-vizuale do të depozitohet në tërësi në bazë vjetore, në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media, në muajin e parë të vitit respektiv.”

10. Pala Përgjegjëse edhe përkundër obligimit ligjor për pagesën e taksës për licencë, në mënyrë të vazhdueshme, duke filluar nga viti 2012 e deri në vitin 2014, ka dështuar në kryerjen e pagesës së taksës për licencë duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2010/02.

Sipas nenit 5, paragrafi 7, të Rregullores KKPM-2010/02 përcaktohet se:

“Mospagimi i taksës së licencës , do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues , në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë edhe me revokim të licencës”.

11. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura gjen se, Pala Përgjegjëse ka dështuar të veproj në pajtueshmëri me nenin 12, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë ndërprerjen e transmetimit të programit, dhe nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2010/02, pasi që nuk ka bërë pagesën e taksës për tri vite me radhë 2012, 2013 dhe 2014.
12. Komisioni, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se, Pala Përgjegjëse edhe përkundër shkresave dhe komunikimeve të shumta, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me nenin të 12, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës,dhe nenin5, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2010/02.

Vendimi

13. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 12 “Ndërprerja e Transmetimit” të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenit 5, paragrafi 1, të Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës për Licencë KKPM-2010/02.
14. Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 12, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bërë ndërprerje të shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit të programit dhe nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2010/02, pasi që në mënyrë të vazhdueshme nuk ka bërë pagesën e taksës për licencë.
15. Komisioni, bazuar në shkeljen e vazhdueshme të nenit 12 “Ndërprerja e Transmetimit” të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, si dhe nenit 5, paragrafi 1, të Rregullores KKPM-2010/02, vendos që licenca e Palës Përgjegjëse, të ndërpritet në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

16. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Komisioni e lëshon këtë vendim


Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediav



27.02.2015

datë